



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA E KURRIKULËS DHE E KUALIFIKIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më __. __. 2025

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORË

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në mbështetje të ligjit nr.69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”; të rregullores së brendshme “Për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm”, me nr. 492 prot, datë 30.07.2020; të urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, nr. 610, datë 20.12.2024 “Për miratimin e Kornizës Kurrikulare dhe planit të veprimtarive për rishikimin dhe përditësimin e paketës kurrikulare të arsimit parauniversitar”, si dhe në zbatim të planit të veprimtarive të ASCAP-it, shpall thirrjen për bashkëpunëtorë në lidhje me hartimin/rishikimin/përditësimin e dokumenteve kurrikulare si më poshtë:

- a) Kurrikulat bërthamë për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar
- b) Paketa e planeve mësimore për të gjitha nivelet dhe llojet e shkollave të arsimit parauniversitar
- c) Programet lëndore të klasave 1-12

Bashkëpunëtorët duhet të përmbushin këto kërkesa:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në një degë të mësuesisë.
- b) Të kenë përvojë pune të paktën 3 vjet eksperiencë pune në arsim.
- c) Të kenë njohuri apo përvojë paraprake në:
 - hartimin e dokumenteve të ndryshme kurrikulare;
 - hartimin e materialeve mbështetëse për mësuesit;
 - projekte apo veprimtari të ndryshme të zhvillimit profesional.
- d) Të kenë aftësi të mira digjitale.
- e) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- f) Të kenë njohuri në gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze).

Kandidatët duhet të dorëzojnë CV-në dhe fotokopje të dokumentit të identitetit pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), brenda datës 20.01.2025, ora 16.30.

Faleminderit!